



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.650/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aida Alimi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Aida Alimi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik PDK, në Vendvotimin : 0901E/10R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017 në ora 13:15, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Aida Alimi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në Vendvotimin 0901E/10R, nuk përputhen votat e kandidatëve të PDK-së me votat e këtij subjekti. Ajo ka theksuar se në këtë vendvotim subjekti politik PDK ka 14 vota, ndërsa kandidatët nuk është e qartë nëse kanë 13 apo 23 vota, pra sipas parashtrueses së ankesës shihet se aty ka ndërhyrje tek lista e kandidatëve gjë e cila shihet në Formularët e shpallur nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur Formularin e Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve (FPR).

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës ka konstatuar se në Formularët e Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve nuk përputhen votat e subjektit politik PDK me votat e Kandidatëve të këtij subjekti, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalë nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë bazuar në nenin 115, 117, 118 dhe 119 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL. Anr.650/2017 me datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.